



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
***Kuvendi - Skupština - Assembly***

---

**Legjislatura VIII**

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,  
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen  
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 112

Prishtinë, më 24.5.2024, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P R O C E S V E R B A L

**Në mbledhje morën pjesë:** Adnan Rustemi, Driton Selmanaj, Artan Abrashi, Dimal Basha, Arijeta Rexhepi, Erxhan Galushi, Hydajet Hyseni Kaloshi, Blerta Deliu-Kodra, Hajdar Beqa dhe Besnik Tahiri.

**Mbledhjen e kryesoi** Adnan Rustemi, kryetar i Komisionit.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë:** Valentin Beiqi, PDK; Lavdim Makshana, IKD; Vullnet Bugaçku, KDI; dhe Valmire Abdullahu, EO.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në Projektligjin nr.08/L-249 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës;
3. Formimi i grupit punues për Projektligjin nr.08/L-276 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve të veçanta për krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga Qeveria dhe ministrat;
4. Formimi i grupit punues për Projektligjin nr.08L-283 për harmonizimin e ligjeve të veçanta me Ligjin nr. 05L-087 për kundërvajtje;
5. Formimi i grupit punues për Projektligjin nr. 08/L-290 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.08/L013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës;
6. Të ndryshme.

## 1. Miratimi i rendit të ditës

*Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## 2. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në Projektligjin nr.08/L-249 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës

**Kryetari**, tha se flet edhe në cilësinë e kryesuesit të grupit të punës për projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, duke paraqitur raportin me amendamente dhe shtoi se grupi i punës ka trajtuar çdo rekomandim dhe vërejtje të Komisionit të Venecias, lidhur me këtë projektligj nën dritën e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese dhe pjesëmarrjen e gjerë të aktorëve institucionalë dhe nga shoqëria civile, por edhe të partnerëve ndërkombëtarë. Po ashtu, tha se grupi i punës e ka trajtuar projektligjin nën për nen dhe raporti me amendamente adreson në bindjen time profesionale secilin rekomandim të Komisionit të Venecias, natyrisht edhe mbi bazën e numrit të anëtarëve të Këshillit Prokurorial, edhe për procesin e përzgjedhjes së anëtarëve jo-prokurorë të Këshillit Prokurorial. Është përvetësuar modeli i zgjedhjes së gjykatësve në Gjykatën Kushtetuese me komision të posaçëm, që e themelon Kuvendi, me përbërje të përfaqësuesve të institucioneve të pavarura që do të kenë përgjegjësinë e përzgjedhjes së rekomandimit të seancës të anëtarëve jo-prokurorë. Grupi i punës e ka trajtuar me objektivitet maksimal në diskutim të hapur me secilin nga aktorët që kanë interes për këtë çështje në funksion të adresimit të rekomandimeve të Venecias dhe natyrisht që mund të ketë dallime në nuanca mbi modelin e rregullimit, por që përpjekja ka qenë e sinqertë, që të sjell një raport me amendamente, respektivisht për të rekomanduar për seancë në lexim të dytë këtë projektligj, që edhe i përgjigjet nevojës për reforma në Këshillin Prokurorial të Kosovës, por në të njëjtën kohë, garanton adresimin e rekomandimeve të Venecias, sikurse është në përputhje me Kushtetutën.

**Driton Selmanaj**, tha se është viti i tretë i kësaj Qeverie dhe mund të shkojë mandati, duke e trajtuar këtë projektligj dhe me iniciativat për të ndryshuar strukturën organizative të Këshillit Prokurorial dhe ka pasur shumë veprime, situata, pasoja dhe vendime të Gjykatës Kushtetuese, dy herë mendime të Komisionit të Venecias. Tani vijmë në situatën, kur ka një ndërrim drastik, sidomos të përbërjes të këtij organi shumë të rëndësishëm për sistemin prokurorial, në krahasim me propozimin e Qeverisë dhe kjo më pas nxjerr një përfundim se a mund të jetë një veprim eksperimental. Qeveria ka propozuar 19 anëtarë të Këshillit Prokurorial, ndërsa këtu është reduktuar në 7, që i bie se është ndryshim drastik i politikës së Qeverisë, dhe në rrethana të tilla, Qeveria do të duhej ta tërhiqte dhe më pas të vinte me një arsyetim tjetër se përse po mendon kështu, pasi që me një vendim paraprak, Gjykata Kushtetuese e pati shpallur kundër kushtetues. Po ashtu, tha se nuk ka qenë pjesë e grupit të punës, sepse parimisht e ka parë që iniciativa nuk është në rregull dhe prandaj tha se ka theksuar më herët, që ky dokument është i papërmirësueshëm dhe tani përsëri ka dilema nëse janë adresuar sidomos rekomandimet e Venecias. Përpos katër anëtarëve që vijnë nga prokuroria një kryeprokuror, një nga Prokuroria Speciale ose nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dhe dy nga radhët e prokurorive themelore dhe tre anëtarë jo-prokurorë të zgjedhur nga Kuvendi, por që mundësia e zgjedhjes së tyre është lënë me shumicë të thjeshtë të deputetëve, që janë të pranishëm dhe që votojnë hipotetikisht me 31 deputetë mund të votohet një anëtar i KPK-së. Sado që mund të kemi referencë se vendimmarrja në Kuvend është e tillë edhe në bazë të përcaktimit të kuorumit, por ekziston një nen në Kushtetutë, ku lejohet pakësimi i të drejtave të njeriut në situata të caktuara, kur me ligj është e përcaktuar dhe me ligj këtu përcaktohet

qartë pse interesi publik është më i madh se interesi privat i dikujt. Deputeti Selmanaj theksoi se interesi publik është që Kuvendi të dërgojë njerëz në KPK, që plotësojnë një standard minimal që është 61 vota, sepse nuk mundet dikush me 31 vota të shkojë dhe të vendosë për politikën e sistemit prokurorial në Kosovë, prandaj kjo është çështja e parë që assesi nuk duhet të pranohet. Çështja e dytë është se është përzgjedhur një komision i ngjashëm për përzgjedhjen e gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese, por kjo nuk është e vërtetë, sepse përbërja që është propozuar këtu është të jetë vetëm një anëtar, që është Kryetari i Kuvendit apo i deleguar i kryetarit të Kuvendit, ndërsa në rastin për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, është Kryetari i Kuvendit apo i deleguari i Kryetarit të Kuvendit dhe përfaqësuesit e partive politike ose shefat e grupeve. Është mirë që kjo është plotësuar edhe me Këshillin Prokurorial dhe Këshillin Gjyqësor, mirëpo nëse reduktohet kjo, vetëm te Kryetari i Kuvendit, i bie që të shumica parlamentare, sepse Kryetari i Kuvendit është gjithmonë i partisë së parë, kështu na ka vendosur një vendim absurd i Gjykatës Kushtetuese dikur, që patjetër Kryetari i Kuvendit duhet të jetë i partisë më të madhe në vend e që i bie se edhe mënyra se si interviston dhe e bën listën e ngushtë, do ta bëjë ai që është i shumicës parlamentare dhe pastaj me 31 vota të kalojë. Gjithashtu mendon që përsëri ka hapësirë për synim të rekomandimeve të Komisionit të Venecias, ku flet se sa më larg të jetë politika prej këtij institucioni, këtij mekanizmi shumë të rëndësishëm dhe shtoi se nuk mund të japë votën për dhe madje mendon se pavarësisht eksperimentit të madh, sepse është bërë veprim eksperimental, në krahasim me propozimin e Qeverisë. Po ashtu, tha se është i bindur që nuk janë adresuar të gjitha rekomandimet e Komisionit të Venecias, dhe si të tillë, nuk mund të votojë për, por do të votojë kundër.

**Kryetari**, tha se sa i përket ndryshimit drastik, është çështje e kontestimit, padyshim edhe thelbi i angazhimit për reformën në Këshillin Prokurorial, është ndryshimi i raportit të anëtarëve prokurorë me anëtarët jo-prokurorë në funksion të ndryshimit të karakterit kooperativist, që nënkupton dominimin aktual të Këshillit Prokurorial nga prokurorët, duke e plotësuar me një element të pluralizmit të profileve të ndryshme, por duke garantuar që nuk bllokohet vendimmarrja, që nuk i mbivendoset pjesa e joprokurorëve sistemit. Në projektligjin e parë, numri ka qenë i ulët, ka qenë 7, mirëpo Gjykata Kushtetuese ka gjetur që raporti prokuror, jo-prokuror, veçanërisht një anëtar që vjen nga Avokati i Popullit, nuk janë në përputhje me Kushtetutën dhe disa elemente të tjera që ndërlidhen me vendimmarrjen në Këshill. Përpjekja e dytë ka qenë përmes rritjes së numrit të anëtarëve në Këshillin Prokurorial, që i përgjigjet nevojës për sigurimin e pluralizmit brenda KPK-së. Komisioni i Venecias ka konsideruar që mbi bazën e numrit të popullsisë që ka Kosova dhe mbi bazën e numrit të prokurorëve që ka Kosova, numri prej 19 anëtarëve është shumë i lartë në këtë Këshill. Rrjedhimisht, nëpërmjet grupit të punës si Kuvend dhe si Komision, në përputhje me rekomandimet e Venecias, ne jemi rikthyer te numri 7, por duke u përpjekur të balancojmë raportin prokuror me jo-prokuror. Zëvendësimi i anëtarëve aktualë do të bëhet gradualisht, në raport me përfundimin e mandatit të rregullt. Njëra nga çështjet që ka gjetur Gjykata Kushtetuese, që nuk është në përputhje me Kushtetutën, në rastin e projektligjit të parë, është ndërprerja e mandatit të anëtarëve aktualë, edhe pse ishte paraparë që përmes shortit, anëtarëve t'u ndërpritet mandati është konsideruar që anëtarëve nuk mund t'u ndërpritet mandati, para përfundimit të mandatit të rregullt. Ky projektligj e konsideron këtë çështje dhe zëvendësimi i anëtarëve aktualë bëhet gradualisht, në bazë të përfundimit të mandatit dhe ky projektligj, pas miratimit në lexim të dytë, efektet përfundimtare do t'i ketë pas disa vitesh në kuptimin e përbërjes së KPK-së, derisa të përfundojë mandati i anëtarëve aktualë. Zgjedhja e anëtarëve jo-prokurorë, në kuptimin e shumicës së thjeshtë, dhe ne jemi Komisioni për Legjislacion, që e kemi përgjegjësi edhe trajtimin e aspektit kushtetues të projektligjeve, por edhe profesionalisht duhet të ndajmë mendjen për një gjë, që Kushtetuta e

Kosovës e përcakton te kompetencat dhe autorizimet e Kuvendit të Kosovës, që vendimet e Kuvendit të Kosovës, çfarëdo qofshin ato, qofshin edhe ligj, miratohen me shumicë të thjeshtë, përveç vendimeve që parasheh Kushtetuta, votim tjetër në mënyrë shprehimore. Kushtetuta e parasheh zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese me 2/3 e deputetëve të pranishëm ose zgjedhjen e Qeverisë me 61 vota, ose zgjedhjen e Presidentit të Republikës me shumicën e përcaktuar dhe jashtë situatave që i përcakton Kushtetuta. Të gjitha vendimet miratohen me shumicë të thjeshtë, po të mos ishte kështu, do të ishim dakord që ta rrisim votën e nevojshme për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Prokurorial, por që kjo do të ishte në kundërshtim me Kushtetutën, ndërsa kjo nuk mund të bëhet me ligj. Pra, nëse kjo çështje nuk do të kontestohet në Gjykatë Kushtetuese, ndoshta do të vazhdonte të mbetej në fuqi, por kushdo që do ta dërgonte në Gjykatë Kushtetuese, me çfarëdo shumice tjetër, përveç shumicës së thjeshtë, do ta nxirrte ligjin në kundërshtim me Kushtetutën. Ajo çfarë ka bërë grupi i punës, është që fokusin e kemi vendosur te Komisioni i posaçëm i selektimit, dhe meqë votimi është me shumicë të thjeshtë, atëherë Komisioni i posaçëm, në përbërje të një anëtari prokuror nga Këshilli Prokurorial, një nga Këshilli Gjyqësor edhe një nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit dhe natyrisht nga Kryetari i Kuvendit, që e drejton komisionin apo ndonjë deputet i caktuar nga ai ose ajo, do të kenë përgjegjësinë e vlerësimit profesional dhe të rekomandimit të seancës. Ndërsa, te çështja se a është ruajtur përbërja e komisionit për përzgjedhjen e gjyqtarëve nga Gjykata Kushtetuese, në këtë rast, modeli është ndjekur, por nuk është reprodukuar dhe kjo me qëllim që të ikim nga politizimi dhe tani të përfshijmë grupet parlamentare me nga një përfaqësues në një komision të tillë, atëherë kjo nuk garanton proces të vlerësimit të depolitizuar. Është e vërtetë që Kryetari i Kuvendit është i shumicës, varësisht se kush do të jetë, por do të jetë vetëm një person në mesin e pesë anëtarëve që do të ketë vetëm mundësinë e poentimit, por nuk do të mbërrijë të diktojë e ta ndikojë, ta dominojë poentimin, sepse do të jenë edhe katër anëtarë të tjerë nga institucionet e pavarura KPK, KGJK, Zyra për Komunitete dhe Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, që në bazë të poentimit profesional, Kryetari i Kuvendit apo deputeti i caktuar, do të jetë subjektiv në vlerësim dhe do të kalohet në poentim. Është përcaktuar edhe metodologjia e vlerësimit gjithmonë për t'u garantuar që poentimi të jetë sa më meritore, e që deputetët të kenë mundësinë e zgjedhjes ose jo.

**Besnik Tahiri**, tha se si Kuvend, në këtë rast si Qeveri, kemi humbur shumë kohë që nga 23 dhjetori, nga kur është dhënë opinioni i Komisionit të Venecias, në raport me shkeljet apo me defektet që ky ligj i ka paraparë dhe çështjet që është dashur t'i rregullojë. Pra, kemi humbur kohë për një çështje e cila është parë shumë hapur edhe nga opinioni publik, por edhe nga Komisioni i Venecias dhe nga shoqëria civile, që rritja e numrit me 8 prokurorë, që nuk janë pjesë e prokurorisë, ka qenë një tendencë serioze e politizimit të një institucioni të pavarur kushtetues. Po ashtu, tha se e mirëpret që kjo Qeveri nuk ka insistuar që ende të mbajë numrin e madh, mirëpo pyetja legjitime që e shtroi edhe deputeti Selmanaj, është se tash nuk po diskutohet të shtohen 8 anëtarë jo-prokurorë, por numri i anëtarëve të KPK-së është zvogëluar nga 19 në 7 anëtarë dhe kjo na shtyn të mendojmë pse po ndodh kjo. Një reflektim serioz ndaj draftit të parë, e kemi pasur nga IKD dhe nga FOL, më 17 korrik të vitit të kaluar, ku çështjet që sot po i diskutohen kanë qenë rekomandime për t'i trajtuar dhe kur flasim për vetëbesimin që të besojmë ne vetë dhe të mos të bëjmë referencë te faktori ndërkombëtar dhe kemi pasur mundësi që me këto rekomandime të IKD dhe të FOL, që kanë qenë të njëjta, të përmbylim dhe mos të mbetet për muajt e fundit të mandatit katërvjeçar të kësaj Qeverie. Te çështja e Komisionit përzgjedhës, tha se është në rregull, me atë se nuk ka përfaqësim të grupeve politike parlamentare. Komisioni përzgjedhës, i përbërë nga Kryetari i Kuvendit, një prokuror i përcaktuar nga KPK, një gjyqtar i përcaktuar nga KGJK, një përfaqësues

nga Këshilli konsultativ i komuniteteve dhe drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, tani po flasim për realitet politik, kryetari vjen nga partia e pare, përfaqësuesi i Këshillit Konsultativ për Komunitete është komunitet, por që emërimet janë politike dhe te drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, ne këtu votojmë. Edhe ky mekanizëm duhet të ketë parasysh që ndikimi politik apo transferi i përgjegjësisë së vendimmarrjes te Komisioni për përzgjedhjen e KPK-së, e ka prapë derën hapur sa i përket ndikimit politik. Edhe pse janë evidente këto dy-tre lëshime, në krahasim me lëshimet që kanë qenë, dallimi është i madh, por me këto probleme nuk mund të votoj për, mirëpo e jap vlerësimin e reflektimit që është i vonuar dhe çelësi i ndikimit politik përmes tre instancave jo-prokurorë është mjaft i madh.

**Hajdar Beqa**, tha se si grup parlamentar i kanë dhënë qëndrimet e tyre në seancë, ku fatkeqësisht ky ligj ka shkuar si lojë pingpongu, gjithë mandatin e kësaj legjislature, ku edhe shoqëria civile edhe ne i kemi dhënë vërejtjet tona, edhe Komisioni i Venecias ka pasur disa herë rekomandime dhe komente, megjithatë dikush mund të thotë se ka qenë qëllim fisnik i Qeverisë, mirëpo është parë që nuk është, sepse numri i anëtarëve ka ndryshuar disa herë dhe ka nënkuptuar se dëshiron të ketë nën kontroll Këshillin Prokurorial. Zvogëlimi i numrit në 7 anëtarë e të jenë vetëm tre anëtarë prokurorë, duke e larguar kryeprokurorin, sepse është sipas detyrës zyrtare, sepse ligji thotë kryeprokurori të jetë kryetar i Këshillit, sipas detyrës zyrtare dhe të kemi tre prokurorë dhe tre jo-prokurorë nuk i bën dobi Këshillit, sepse duhet të kemi më shumë prokurorë se jo-prokurorë, sepse po flasim për Prokurori të Shtetit, për prokurorë të të gjitha niveleve. Sa i përket përbërjes tek Komisioni, edhe po të mos ketë përfaqësues të grupeve të tjera politike, është Kryetari i Kuvendit ose përfaqësuesi i tij, por përfaqësuesi i tij të jetë anëtar i Kryesisë së Kuvendit. Ai tha se si Parti Demokratike, në këtë fazë, nuk e përkrahim këtë projektligj dhe do ta analizojmë se a ka elemente që të dërgohet përsëri në Gjykatën Kushtetuese dhe nuk e shohim si të mundur që në këtë legjislaturë të hyjë në funksion, sepse edhe po të shkojë mandati deri në fund sipas Kushtetutës, rrethanat në të cilat jemi po vërejmë që ka elemente të shkeljes së Kushtetutës.

**Besnik Tahiri**, tha se kryeprokurori i Shtetit, në momentin kur është në një instancë të lartë, në këtë rast të KPK-së, ndikimi i tij në vendimmarrje është shumë i madh, ndërsa kur e lexojmë ligjin thotë se asnjë prokuror që është kryeprokuror i një prokurorie, nuk mund të jetë pjesë, përveç kryeprokurorit. Po ashtu, pyeti nëse është diskutuar kjo çështje nga Komisioni i Venecias.

**Hajdar Beqa**, tha se edhe më herët, kryeprokurori ka qenë në Këshill, mirëpo me ligje ndërkohë është transferuar dhe nuk ka qenë në Këshill dhe tani nëse kemi tre anëtarë prokurorë dhe tre anëtarë jo-prokurorë dhe kryeprokurorin e zgjedh Këshilli, si do ta zgjedhin këta 6 anëtarë, sepse nuk mund të marrë pjesë në zgjedhje kryeprokurori.

**Driton Selmanaj**, tha se nuk është hera e parë që e kemi referencë mënyrën e vendimmarrjes në Kushtetutë dhe referenca nga neni 80 në Kushtetutë, titulli i këtij neni është miratimi i ligjeve dhe thotë: “ligjet, vendimet dhe aktet tjera miratohen nga Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e përcaktuar me këtë Kushtetutë”, mirëpo flet për miratimin e akteve dhe jo kur Kuvendi është organ zgjedhor, jo kur zgjedh, por vetëm kur miraton ligje dhe në të gjitha dispozitat tjera që janë në këtë nen i referohen vetëm formës se si miratohen ligjet. Pika 2, flet kur ligji miratohet nga Kuvendi dhe kthehet nga Presidenti. Deputeti Selmanaj tha se interpretimi i tij është se me ligj mund të ndryshojmë formën e zgjedhjes se përfaqësuesve që Kuvendi i dërgon diku dhe mendon që shumica e thjeshtë e

deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, e ul rëndësinë e këtij institucioni shumë të rëndësishëm si KPK-ja dhe nuk është në rregull që dikush të zgjidhet dhe të shkojë në KPK me 31 vota. Po ashtu, tha se nuk e ka të qartë se përse në këtë komision duhet të jetë drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, pse në këtë komision duhet të jetë përfaqësuesi i Këshillit Konsultativ për Komunitete, kur me ligj nuk i është dhënë e drejta e përfaqësimit në KPK, përveçse kur është fjala për gjininë apo pakicat, atëherë kanë përparësi dhe kjo nënkupton që ata kurrë nuk mund të përfaqësojnë, sepse vetëm pse konkurren një pjesëtar i pakicave, nuk mund t'i jepet përparësi. Më tej, tha se pajtohet me deputetin Tahiri, kur tha se ideja është të mbizotërojë politika në zgjedhjen e këtyre njerëzve, për t'i dërguar në Kuvend dhe të tentojë që tërë kohën t'i pengojë në kuorum për vendimmarrje. Grupi i punës ka bërë punë të mirë, në krahasim se si ka qenë ligji, por jo atë që duhet të bëhet.

**Besnik Tahiri**, tha se kur iu referohet 31 deputetëve, e sheh pak më ndryshe. Pra, votimi ndodh në kuti dhe është votim i fshehtë, që nënkupton 120 deputetë dhe numri 31 deputetëve nuk është 31 deputetë, por thotë me shumicën e thjeshtë pjesëmarrëse dhe numri prej 31 deputetëve vjen në shprehje vetëm kur opozita nuk merr pjesë.

**Driton Selmanaj**, tha se standardi minimal për kuorum është 61 deputetë për të votuar, mirëpo prej këtyre 61 deputetëve, po të votojnë 31, është në rregull.

**Besnik Tahiri**, tha se në këto votime, zakonisht ka mobilizime, sepse ka lobime për t'i votuar kandidatët e caktuar.

**Driton Selmanaj**, tha se kjo ka ndodhur për shkak se propozimet kanë ardhur nga Komisioni, ndërsa tash do të vijnë nga Kryetari i Kuvendit dhe me këtë strukturë të Komisionit nuk do të ketë lobime fare, sepse mund të jenë tre kandidatët, që i propozon Kryetari i Kuvendit, me këtë Komision.

**Besnik Tahiri**, tha se argumentin e shumicës së thjeshtë me votë të fshehtë nuk e shoh shumë problematike, mirëpo si problem e sheh kompozicionin e Komisionit. Në një rast konspirativ, ne e kemi ulur në 7 numrin e anëtarëve të KPK-së, mirëpo te Komisioni pastaj e kemi gdhendur procesin.

**Erxhan Galushi**, tha se në lidhje me çështjen e përbërjes së Këshillit, këtu është e qartë se numri i anëtarëve të Këshillit është 7, por në diskutimin e deputetit Selmanaj, ku tha se pse duhet të jetë një anëtar nga Këshilli konsultativ për komunitete në përbërjen e Komisionit për përzgjedhjen e anëtarëve në KPK, shtoi se këtë e mbulon pika 4, ku flet për zgjedhjen e anëtarëve sesi do të dukej kjo zgjedhje e anëtarëve dhe thotë qartë që anëtarët e Këshillit, bazuar në kompetencën, përvojën dhe njohuritë e tyre dhe pasqyrojnë natyrën shumetnike dhe parimet e barazisë gjinore në Republikën e Kosovës. Në bazë të kësaj, secili anëtar i komuniteteve jo-shumicë, i cili mendon që nuk përfaqësohet dhe që konkurren për të qenë anëtar i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ka bazë për t'u ankuar, pse nuk është përbërja shumetnike në Këshillin Prokurorial të Kosovës, kështu që pika 4 e lë të hapur që në mesin e kësaj përbërje të ketë edhe anëtarë të komunitetit jo-shumicë, por sigurisht të parashihet edhe barazia gjinore. Edhe pse e kuptoj që duhet të ceket siç është tek Këshilli Gjyqësor i Kosovës, që thotë se një anëtar i komunitetit serb dhe një nga komunitetet jo-shumicë, por këtu për shkak të numrit është lënë kështu. Pasqyrimi i një anëtari të Këshillit

Prokurorial të Kosovës duhet të duket në bazën e pikës 4, te përbërja shumetnikë dhe ndarja gjinore.

**Kryetari**, tha se tërhiqet nga amendamentet që ka propozuar për Ligjin për KPK-në, sepse të njëjtat kanë pësuar ndryshime gjatë grupit punues dhe raporti me amendamente është raporti përfundimtar.

*Meqë nuk pati diskutime tjera, kryetari konstatoi se me 6 vota për dhe 1 votë kundër, Komisioni miratoi raportin me amendamente dhe vendosi që, Kuvendit dhe komisioneve kryesore, t'ua paraqesë këtë:*

## **R a p o r t**

### **Për Projektligjin nr. 08/L-249 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës**

- 3. Formimi i grupit punues për Projektligjin nr.08/L-276 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve të veçanta për krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga Qeveria dhe ministrat**

**Kryetari** propozoi që grupin e punës për Projektligjin nr.08/L-276 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve të veçanta, për krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga Qeveria dhe ministrat dhe Projektligjin nr.08/L-283 për harmonizimin e ligjeve të veçanta me Ligjin nr. 05/L -087 për kundërvajtje, të jenë një grup i përbashkët me këta anëtarë.

*Meqë nuk kishte diskutime tjera, kryetari konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë:*

## **V e n d i m**

**Për formimin e grupit të punës për për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve të veçanta për krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga Qeveria dhe ministrat.**

1. Formohet grupi i punës në përbërje:

Erxhan Galushi, kryesues,  
Adnan Rrustemi, anëtar, dhe  
Dimal Basha, anëtar.

- 4. Formimi i grupit punues për Projektligjin nr.08L-283 për harmonizimin e ligjeve të veçanta me Ligjin nr. 05L-087 për kundërvajtje**

**Kryetari** propozoi që grupin e punës për Projektligjin nr.08/L-283 për harmonizimin e ligjeve të veçanta me Ligjin nr. 05/L -087 për kundërvajtje, të jenë këta anëtarë.

*Meqë nuk kishte diskutime tjera, kryetari konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë:*

## **V e n d i m**

**Për formimin e grupit të punës për për ndryshimin dhe plotësimin e Projektligjit nr. 08/L-283 ligjeve të veçanta me ligjin 05/L-087 për kundërvajtje.**

1. Formohet grupi i punës në përbërje:

Erxhan Galushi, kryesues,  
Adnan Rrustemi, anëtar, dhe  
Dimal Basha, anëtar.

**5. Formimi i grupit punues për Projektligjin nr. 08/L-290 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.08/L013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës**

**Kryetari**, tha se në këtë projektligj, është vetëm një nen dhe nuk ka kuptim ta formojmë një grup pune, andaj do ta sjellim direkt në Komision dhe e procedojmë për në Kuvend dhe në komisionet kryesore.

## **6. Të ndryshme**

Në këtë pikë nuk pati ndonjë çështje tjetër për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:  
Stafi mbështetës i Komisionit.

**Adnan Rrustemi,**  
Kryetar i Komisionit

-----